



BULETIN INFORMATIV

PRILL - QERSHOR 2024

Kuvendi i Shqipërisë miraton Rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së ERRU për vitin 2023

Në seancën plenare të datës 06.06.2024, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Projektrezolutën për Vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Ujit (ERRU) për vitin 2023. Kuvendi i Shqipërisë vlerëson punën e ERRU në kuadër të reformimit të sektorit UK; licencimit të shoqërive të reja rajonale; nënshkrimin e dy marrëveshjeve të bashkëpunimit me Agjencinë Kombëtare të Ujësjetës Kanalizimeve (AKUK) hartimin e Strategjisë Sektoriale të Shërbimeve UK 2020-2030 si dhe kontributin e ERRU si pjesë raportuese e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian dhe grupit për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2023-2030. Në rezolutën e miratuar përfshihen edhe 13 rekomandime të Kuvendit të Shqipërisë për vitin aktual (2024), të cilat lidhen me asistencën e nevojshme të ERRU-së për shoqëritë rajonale që hasin problematika në propozimet për tarifa të reja, bashkëpunimin e mëtejshëm me AKUK në ngritjen e një sistemi të integruar të të dhënave dhe Treguesve Kryesorë të Performancës, llogaridhënien e shoqërive për pajisjen e të gjithë klientëve me matës, monitorime mbi cilësinë dhe sasinë e ujit, ndërgjegjësimin e konsumatorëve për të drejtat dhe detyrimet që kanë, reduktimin e abuzimeve në punësimin e stafit të shoqërive, e veçanërisht ndjekjen e një politike agresive ndaj shoqërive për përmirësimin e Treguesve të Performancës.

PËRMBAJTJA

- REZOLUTA PER 2023
- VENDIMET E KKRR
- PJESËMARRJA NË AKTIVITETE
- TAKIME PUNE
- ARTIKUJ STUDIMORË



Në kuadër të hapjes së negociatave me BE, Kuvendi rekomandon gjithashtu që ERRU të kontribuojë në përbushje të kërkesave të Acquis në lidhje me Direktivat Evropiane për Ujin e Pijshëm, Ujërat e Ndotura dhe Llumrave të ITUN.

VENDIMET E KKRR

Nga muaji prill deri në qershor të vitit 2024, Komisioni Kombëtar Rregullator ka zhvilluar disa mbledhje në të cilat ka miratuar tetë vendime, midis të cilëve veçojmë:

- ✓ Vendim Nr. 13, “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për Shoqërinë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier sh.a”
- ✓ Vendim Nr.14 “Për disa ndryshime në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr.6, datë 22.02.2023 ‘Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës’”
- ✓ Vendim Nr.15 “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për Shoqërinë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a”
- ✓ Vendim Nr.16 “Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshimin e nivelit tarifar të Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Pogradec sh.a”

LICENCA

Në sektorin e ujit operojnë aktualisht 19 shoqëri ujësjiellës kanalizime, 13 prej të cilave të licencuara si shoqëri rajonale: Shoqëria Rajonale UK Durrës, Lezhë, Korçë, Kukës, Gjirokastrë, Berat, Fier, Lushnje, Pogradec, Elbasan, Sarandë, Dibër, Shkodër dhe 6 shoqëri të tjera UK: Tiranë, Vorë, Kamëz, Vlorë, Selenicë dhe Himarë. Në tre mujorin e dytë të vitit 2024, pranë ERRU është paraqitur dhe ka marrë aprovim kërkesa për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe teknik nga Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës.

TARIFA

Në 3-mujorin e dytë të vitit 2024, Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) ka miratuar tarifat e propozuara nga Shoqëria Rajonale UK Fier dhe Shoqëria Rajonale UK Durrës si dhe ka në proces analize aplikimin për ndryshim të nivelit tarifar për Shoqërinë Rajonale UK Pogradec. Në 3-mujorin e parë të këtij viti, KKRR miratoi vendimin me tarifat e shërbimit UK për Shoqërinë Rajonale UK Lezhë, duke e çuar në katër numrin e shoqërive rajonale që operojnë me tarifa të reja që pas reformimit të sektorit të ujit në fillim të vitit 2022.

PJESËMARRJA NË AKTIVITETE



ERRU merr pjesë në Asamblenë e 31 & 32 të Shoqatës Evropiane të Rregullatorëve të Ujit

Në datat 23 prill dhe 19 qershor, Shoqata Evropiane e Rregullatorëve të Ujit (WAREG) zhvilloi dy mbledhjet e para të Asamblesë së Përgjithshme për këtë vit. Kryetari i Entit Rregullator të Ujit, Z. Ndrim Shani dhe Sekretari i Përgjithshëm, Znj. Fatime Imeraj përfaqësuan ERRU-në në Asamblenë e 31, të mbajtur në Firence (Itali), e cila i parapriu Konferencës mbi qëndrueshmërinë dhe investimet në sektorin e ujit në Evropë. Shumë institucione të Bashkimit Evropian, rregullatorë dhe aktorë të tjerë interesi u mbledhën në këtë konferencë për të promovuar qëndrueshmërinë e sektorit të ujit dhe inkurajuar investimet në sektor. *Asambleja e Përgjithshme e 31-të e WAREG* u fokusua në investimet ndërkombëtare në sektorin e ujit dhe rolit të rregullatorëve në incentivimin e tyre, shoqëruar me disa prezantime dhe diskutime edhe nga përfaqësues të sektorit privat dhe institucione financiare. Ndërsa *Asambleja e Përgjithshme e 32-të* solli në tryezën e diskutimeve barrierat kryesore me të cilat përballlet sektori i ujësjellës kanalizimeve dhe rregullatori i ujit në secilin vend anëtar, si dhe



prioritetet kyçe në të ardhmen e afërt për qëndrueshmërinë financiare të sektorit të shërbimeve për konsumatorët dhe zbatimin e direktivave Evropiane për ujërat. Duke qenë se punimet e asambleve përkrijnë me 10 vjetorin e themelimit të shoqatës, këto takime shërbyen edhe si një reflektim mbi arritjet në bashkëpunim me anëtarët e saj, mes të cilëve është dhe ERRU.

ERRU në Konferencën dhe Forumin e Ujit të Danubit

Një përfaqësi e lartë nga Enti Rregullator i Ujit, kryesuar nga kreu i ERRU, Z. Ndrim Shani morën pjesë në Konferencën dhe Forumin e Ujit të Danubit që u zhvillua në Brasov të Rumanisë, në datat 28-30 maj. Gjatë punimeve të Konferencës, delegacione nga rregullatorët e vendeve që janë pjesë e Rajonit të Danubit u mbledhën në një tryezë të rrumbullakët për të shkëmbyer informacione rreth zhvillimeve të fundit të shërbimeve rregullatorë në fushën e ujësjellës kanalizimeve në vendet përkatëse si dhe forcimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të eksperiencave përkatëse me qëllim fuqizimin institucional të tyre. Fokus i diskutimeve ishin Treguesit e Harmonizuar të Performancës në Sektorin Evropian të Ujit dhe mbulimit të kostove të këtyre shërbimeve për një sektor të qëndrueshëm financiarisht.



Në dy ditët e Konferencës u diskutua mbi ndikimin e ndryshimeve klimatike në sektorin e ujit. Në sesione të dedikuara, ekspertë nga vende të ndryshme sollën zhvillimet më inovative, ndikimet e tyre në shoqëri përmes shembujve dhe praktikave më të mira.



Projekti i Modernizimit të Sektorit të Ujit, Banka Botërore takim pune në ERRU

Në 11 prill, ERRU priti në një takim përfaqësues nga Banka Botërore dhe Konsulentët e huaj, të kontraktuar për të mbështetur me asistencë zbatimin e Programit Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri. Kryetari i ERRU, Z. Ndriçim Shani diskutoi me shefin e ekipit, Z. Sadok Hidri Hellman dhe ekspertët e ngarkuar për zbatimin e këtij programi aspekte të zbatimit të metodologjisë së caktimit të tarifave në kushtet e reformës së agregimit si dhe hartimin e planeve të biznesit për shoqëritë UK, si pjesë e përgatitjes së propozimeve të tyre për tarifa të reja pranë ERRU-së. Qëllimi kryesor i Programit është përmirësimi i performancës financiare të shoqërive dhe rritja e aksesit të qytetarëve në shërbimet UK.



ERRU takim të Përbashkët pune me Autoritetin Rregullator të Kosovës (ARRU)

Në kuadër të bashkëpunimit me Autoritetin Rregullator të Ujit në Kosovë (ARRU), Enti Rregullator i Ujit (ERRU) zhvilloi takimin e radhës për të diskutuar qasjet e dy rregullatorëve mbi Metodologjinë e Tarifave, Monitorimin e Performancës së Shoqërive UK dhe Trajtimit të Ankesave të Konsumatorëve. Gjatë takimit, kryetari i ERRU-së, Z. Ndriçim Shani dhe Drejtoresha e ARRU-së, Znj. Hajrie Morina vunë theksin tek rëndësia e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të eksperiencave mbi çështje të caktuara të sektorit të ujit në vendet respektive. Aktualisht, Shqipëria është e përfshirë në reformën e agregimit, një formë organizimi që Kosova e ka zbatuar që në fillimet e saj dhe ka një përvojë të konsoliduar.

ARTIKUJ STUDIMORË

“Menaxhimi i Qëndrueshëm i Burimeve Ujore dhe Roli i Rregullatorit të Sektorit UK”

Artikull nga:
Ndriçim Shani, Kryetar i ERRU

Ka tashmë disa dekada që ka dalë në pah problematika e nevojës urgjente të menaxhimit racional të këtyre burimeve për shkak të faktorëve negative në disfavor të tyre, nga njëra anë nga rritja e vazhdueshme e kërkesës për ujë nga popullsia dhe industria, kompromentimi i cilësisë së tyre nga aktiviteti i ligjshëm dhe i paligjshëm i ujërave të përdorura që shkakton ndotjen e tyre, dhe së fundi edhe influenca negative e ndryshimeve klimatike (përmbajtje/thatësira). Politikat e menaxhimit racional të ujit janë të lidhura ngushtësisht me Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore,



ku përveç plotësimit të nevojave për pirje parashikohen edhe kërkesat e përdoruesve të tjerë të ujit për nevoja të bujqësisë, peshkimit, me argëtimet në fushën e ujit etj. [Artikulli i plotë](#)

